Përtej neurokirurgjisë: Hidrocefalia me presion normal dhe sfidat e kujdesit afatgjatë te pacientët e moshuar

Erion Musabelliu MD

Fusha shkencore: Sëmundjet kronike dhe multimorbiditeti

Hyrje: Plakja e popullsisë shoqërohet me rritjen e prevalencës së sëmundjeve kronike neurologjike, multimorbiditetit dhe varësisë funksionale. Hidrocefalia idiopatike me presion normal (HPMN) përfaqëson një patologji neurologjike potencialisht të trajtueshme te pacientët e moshuar, e karakterizuar nga triada klinike: çrregullimet e ecjes, dëmtimi kognitiv dhe çrregullimet urinare. Megjithëse ndërhyrja neurokirurgjikale, nëpërmjet vendosjes së një sistemi derivimi të likidit cerebrospinal, mund të përmirësojë gjendjen funksionale të pacientit, ajo nuk eliminon nevojat komplekse të kujdesit afatgjatë dhe ndikimin e sëmundjeve shoqëruese.

Qëllimi: Të evidentojë HPMN-në si model të një patologjie neurologjike kronike në kontekstin e plakjes së popullsisë dhe të theksojë rëndësinë e bashkëpunimit multidisiplinar dhe të kujdesit infermieror të vazhdueshëm në arritjen e rezultateve optimale afatgjata.

Përmbajtja: Prezantimi trajton karakteristikat klinike, sfidat diagnostikuese dhe parimet e trajtimit neurokirurgjikal të HPMN-së, duke u fokusuar veçanërisht në bashkëshoqërimin me patologji si hipertensioni arterial, diabeti mellitus, dëmtimi kognitiv dhe brishtësia geriatrike. Vëmendje e veçantë i kushtohet kujdesit pas ndërhyrjes kirurgjikale, monitorimit neurologjik, identifikimit të hershëm të komplikacioneve të sistemit të derivimit, parandalimit të rrëzimeve, rehabilitimit të lëvizshmërisë, kujdesit për kontinencën, administrimit të medikamenteve dhe edukimit të pacientit e familjarëve.

Përfundime: Menaxhimi i HPMN-së nuk përfundon në sallën e operacionit. Bashkëpunimi ndërmjet neurokirurgut, neurologut, geriatrit, infermierit dhe specialistëve të rehabilitimit është thelbësor për ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Infermierët kanë një rol kyç në vazhdimësinë e kujdesit, parandalimin e komplikacioneve dhe përkthimin e suksesit kirurgjikal në përmirësim të qëndrueshëm funksional.

Fjalë kyçe: Hidrocefalia me presion normal; multimorbiditeti; kujdesi infermieror; neurokirurgjia; rehabilitimi.